



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BUJQESISE, USHQIMIT DHE MBROJTJES SE
QENDRA E KONSUMATORIT
TRANSFORMIMIT TE TEKNOLOGJIVE BUJQESORE
DEPARTAMENTI I TOKES DHE UJIT
SEKTORI I UJRAVE



PROJEKTI NR. 9

TITULLI : “Vleresim teknik per sistemin e kullimit dhe hidrovoreve, administrimi dhe funksioni i tyre ne kushtet e urbanizimit,evidentimi i ndertimeve qe cenojne funksionimin e tyre per zonen e ultesires perendimore”

Pergatitur nga Sektori Ujerave: S.U



Kapitulli VII

VII. Konkluzione dhe rekomandime

Nepermjet ketij programi u be e mundur evidentimi i atyre skemave dhe objekteve te infrastruktures se kullimit dhe ujitjes te cilat ne kushtet e reja kane humbur karakterin bujqesor dhe ju sherbejne zonave urbane. Per shkak te qellimit te ndertimit te tyre ato jane aktualisht ne inventarin e bordeve te kullimit te cilat kane dhe rolin e mirembajtjes dhe funksionimit.

- Meqense skemat e studiuara kane humbur qellimin e tyre bujqesore dhe disa prej tyre ende e ruajne ate, per te rritur shkallen e pergjegjesise te administrimit te tyre rekomandojme :
 - a) Skema te cilat kane humbur teresisht qellimin e tyre bujqesore per shkak te levizjes demografike eshte e domosdoshme qe MBMUK-ja ti propozoje Keshillit te Ministrave qe me VKM t'ju kaloje ne administrim organeve te pushtetit lokal dhe te zhvishen nga detyrimet e administrimit Bordet e Kullimit ne Qarqe.
 - b) Per infrastrukturen e ujitjes dhe kullimit qe vazhdojne ta ruajne qellimin e tyre bujqesor por qe mbi to jane bere ndertime me ose pa leje, rekomandojme te hartohet nje marrveshje e perbashket midis 2 ministrive. MBMUK-se dhe Ministrise se Pushtetit Lokal duke specifikuar pergjegjsite e perbashketa dhe individuale te organeve te tyre vartese.
- Meqense ky studim eshte kompleks dhe voluminoz del nevoja e vazhdimit te kryerjes se tij gjate vitit 2009 ne ate pjese te infrastruktures problematike. Do te rekomandonim qe ne buxhetin e vitit 2009, MBMUK-ja dhe Pushteti lokal te mos japin financime respektivisht ne bashkite dhe Bordet, mbasi efektiviteti i tyre eshte shume i ulet.

V.I 3 Rezultatet e analizave te ujit ne rezervuare

Rezultatet e analizave te ujit te rezervuarit te Thanës tregojne se keto ujera ne pergjithesi jane te pasura me kripera te cilat mund te shkaktojne probleme te lehta ose mesatare kripezimi. Duke ju referuar treguesve tane veme re se vlera e konduktivitetit elektrik, qe eshte edhe treguesi baze i ketij fenomeni para sezonit ujites dhe gjate tij eshte normale e ulet dhe mbas sezonit ujites vjen duke u rritur ne 1.45 Ms/m por gjithsesi brenda limiteve te lejuar. Kjo vjen si rezultat se ne rezervuarin e Thanës pavarsisht se ushqehet me ujerat e lumit Devoll ka nje sere burimesh nentokesore te pasura me kripera qe ndikojne drejtperdrejt ne kripezimin e ujit dhe kjo vihet re kur prurja e ketyre ujerave rritet. Prandaj si rregull rekomandohet kur bie niveli i ujerave ne rezervuar duhet detyrimisht te hapen portat dhe te futen ujerat e lumit Devoll me qellim qe te kryhen shplarjet dhe per te ulur koncentrimin e ketyre kriperave. Veme re se nga kriperat treguesit e Mg dhe te Na jane ne kufije paksa te larte mbi mesataren e lejuar. Permbajtja e larte e Magnezit mund te shkaktojte pengesa ne thithjen e e kalciomit te bimet ndersa permbajtja pak e larte e natriumit dhe klorit mund te shkaktojte probleme te lehta te toksicitetit te bimeve.

Duke ju referuar vlerave te treguesve te monitoruara nder vite per keto objekt veme re se keto vit kemi nje normalizim te sasise se kriperave qe permban ujerat, gje e cila nuk ka ndikuar keto vit ne prodhimtarine e kulturave bujqesore.

2. Cilesia e ujerave ne rrjetin kullues duke e quajtur ujin si ndotesin kryesor te tokes bujqesore ne periudhen e lagesht te vitit dhe ate te thate eshte sinjektiv per ndikimin qe ushtron qofte si ndotes or edhe si transportues i elementeve ndotes ne ngastra ne kushtet kur ne rrjetin kullues shpesh hidhen mbeturina dhe mbetje urbane por edhe kur n kolektore shkarkohen nje pjese e mire e kanaleve te ujerave te zeza etj. ne piken monitoruese te kolkorit te hidrovorit te Hamallajt veme re se treguesit me te larte jane ato te konduktivitetit elektrik qe i kalojne kufjte e lejuar deri 3 here ne vleren mesatare 12.6Ms/m. kjo tregon se ujerat kane perqendrim te madh te kriperave. Vlera e ph eshte perseri e larte. Po te veme re shikojme se permbajtja e kriperave si magnez, kalcium, natrium eshte mbi normat e lejuara si dhe prembajtja e amonjakut, potasit fosfatet jane ne tregues te larte. Keta tregues flasin se prania e elementeve ndotes eshte e larte dhe mungesa e infrastruktures se kullimit do te beje te mundur qe edhe tokat bujqesore te kesaj zone do te ndoten dhe do ti mbartin keto elemente. Eficensa e kullimit eshte po aq e rendesishme sa edhe ujitja per mos ndotjen e tokes dhe rritjen e kulturave bujqesore te zones.

Drejtuesi i Projektit
Ing. Ermir JAUBELLI